

V E N D I M
P E R R E G J I S T R I M I N E P E R S O N I T J U R I D I K

Sot, me daten...08.04.99..., une gjyqtarja e Gjykates se Rrethit Tirane...Prulla...Lofe..., pasi shqyrtova kerkesen dhe materialin e paraqitur nga drejtori i shoqerise se kontrolluar "ARMO"SHA per regjistrimin e saj si shoqeri tregtare "ARMO" SHA Fier

K O N S T A T O V A :

Kerkuesi, shoqeria "ARMO" SHA, ka paraqitur kerkesen per t'u regjistruar si person juridik, ne formen e nje shoqerie anonime pa oferte publike, te krijuar mbi bazen e ristrukturimit te ish shoqerise "ALBPETROL" sipas Vendimit te Keshillit Ministrave nr.756 date 26.11.1998, me kohezgjatje pa afat te caktuar, me aksioner te vetem shoqerine kontrolluese "APC" SHA Tirane, me kapital themeltar 3 268 000 000 leke, i ndare ne 3 268 000 aksione, me vlere nominale secili prej 1 000 leke, me objekt veprimtarie rafinimin e naftes, shperndarjen dhe marketingun e produkteve te rafinuara nepermjet tregtimit ne te gjitha format te nenprodukteve te naftes e te gazit, me seli ne qytetin e Fierit.

Dokumentacioni i paraqitur, akti i themelimit, statuti dhe kerkesa per regjistrimin e shoqerise tregtare anonime si person juridik jane te plota, te bazuara ne ligj dhe si te tilla duhet te pranohen.

P E R K E T O A R S Y E :

Ne baze te ligjit nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare", si dhe nenit 33 te ligjit nr.7667 date 28.01.1993 "Per regjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare"

V E N D O S A :

Regjistrimin si person juridik te shoqerise anonime "ARMO" SHA Fier, me kohezgjatje pa afat te caktuar, me kapital themeltar 3.268.000.000 leke, me aksioner te vetem shoqerine kontrolluese "APC"SHA Tirane, me vlere nominale te aksionit 1 000 leke dhe me objekt veprimtarie rafinimin e naftes, shperndarjen dhe marketingun e produkteve te rafinuara, nepermjet tregtimit ne te gjitha format te nenprodukteve te naftes e te gazit.

Antaret e pare te Keshillit Mbikqyres jane:

1. Bujar Leka
2. Piro Dode
3. Rajmonda Stefa
4. Piro Liko
5. Shpetim Nishani
6. Ilir Dano

Kunder vendimit lejohet ankim ne shkalle te dyte.

GJYQTARE
Drita Capi
[Signature]

URDHER REGJISTRIMI

Me

1. L. 157

2a. "Duma" S.H.A

b. 3268000 lek.

c. Popullsia e qytetit, depardolje
dhe maritimi i produkteve
te qytetit dhe qytetit.

d. Fier.

3. Dredhja
Tevellbi Mbledhjes
Drektorit

4. Statuti nenshkruar me date 06.04.99

5. Data e neq. shiritit

Statuti 9 Fierc

Njoftime: a shoqeris

b. dhomen e tregtis

c. organit perkatues financiar

d. zyres se statistikes

Publikime:

AKT THEMELIMI

Ne baze te ligjit nr.7638 date 19.11.1992"Per shoqerite tregtare", shoqeria "APC"SHA Tirane ka vendosur:

Neni 1

Te themelohet shoqeria me emertimin "ALBANIAN RAFINERING AND MARKETING OF OIL" SHA dhe emertimin e shkurtuar "ARMO" SHA me statusin e shoqerise anonime pa oferte publike. Shoqeria "ARMO" SHA eshte shoqeri e kontrolluar nga shoqeria anonime "APC" Tirane.

Neni2

Shoqeria themelohet per te vepruar ne gjithe teritorin e vendit per nje afat te pacaktuar. Ajo e ushtron aktivitetin e saj ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

Neni 3

Selia e shoqerise eshte ne qytetin e Fierit.

Neni 4

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte rafinimi i naftes, shperndarja dhe marketingu i produkteve te rafinuara nepermjet tregtimit ne te gjitha format te nenprodukteve te naftes e te gazit. Shoqeria do te zhvilloje dhe çdo aktivitet tjeter te mundshem e te ligjshem ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi.

Neni 5

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 3 268 000 000 leke. Ai eshte i ndare ne 3 268 000 aksione, secili me vlere nominale 1 000 leke.

Neni 6

Aksionet e shoqerise se kontrolluar "ARMO" SHA zoterohen ne masen 100% nga shoqeria kontrolluese "APC" SHA Tirane.

Neni 7

Organet drejtuese te shoqerise jane

Asambleja

Keshilli Mbikqyres

Drejtoria

Dispozita te hollesishme per funksionimin e tyre percaktohen ne statut.

Neni 8

Marredheniet ekonomike e financiare te shoqerise "ARMO" SHA me shoqerine kontrolluese "APC" Tirane, si dhe marredheniet e shoqerise "ARMO" SHA me shoqerite e tjera te kontrolluara nga shoqeria kontrolluese "APC" SHA Tirane, rregullohen me marreveshje ndermjet paleve, marreveshje qe miratohen nga Keshilli Mbikqyres i shoqerise "APC" Tirane.

Neni 9

Dispozita te hollesishme per veprimtarine e shoqerise percaktohen ne statut.

Neni 10


Data e fillimit te veprimtarise se shoqerise do te konsiderohet 01.04.1999.

SHOQERIA "APC" SHA Tirane


Me autorizim te Ministrit Ekonomise Publike e Privatizimit

DREJTORI PERGJITHSHEM

KASTRIOT BEJTAJ



Tirane me



STATUTI

I SHOQERISE "ARMO" SH. A.

Ne baze te Ligjit 7638 dt.19.11.1992 "Per Shoqerite Tregetare" dhe mbeshtetur ne Aktin e Themelimit, METE nxjerr kete statut me kushtet e meposhteme:

KREU I

Emertimi, selia, afati

Neni 1

Eshte themeluar shoqeria anonime pa oferte publike me emertimin "Albanian Refinering and Marketing of Oil" Sh.a. dhe me emertimin e shkurtuar "ARMO" Sh.a Fier.
Shoqeria "ARMO" sh.a eshte shoqeri me kapital 100 % shteteror me aksioner te vetem METE .

Neni 2

Shoqeria krijohet per te vepruar ne te gjithe territorin e vendit per nje afat te pacaktuar.

Neni 3

Shoqeria ka seline e saj ne qytetin e Fierit. Selia e shoqerise mund te ndryshoje me vendim te Asamblese, duke respektuar dispozitat ligjore ne fuqi.

Neni 4

Ne veprimtarine e saj shoqeria zbaton legjislacionin shqiptar, normat e percaktuara ne aktin e themelimit dhe ne kete statut.

KREU II Objekti i veprimtarise

Neni 5

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte rafinimi i naftes, shperndarja dhe marketingu i produkteve nepermjet tregimit ne te gjitha format te nenprodukteve te naftes dhe gazit. Shoqeria do te zhvilloje dhe cdo aktivitet tjeter te mundshem dhe te ligjshem ne perputhje me interesat e saj.

Neni 6

Ne lidhje me objektin e veprimtarise shoqeria trashegon dhe merr mbi vete te gjitha te drejtat dhe detyrimet qe shoqeria e meparshme " Albpetrol " sh.a ka patur nga marreveshjet dhe kontratat per perpunimin dhe tregimin e naftes, gazit e nenprodukteve te tyre.

KREU III (Kapitali Themeltar)

Neni 7

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 3 268 000 000 leke.
Ai eshte i ndare ne 3 268 000 aksione te se njejtës kategori, secili me vlere nominale 1 000 leke.

Neni 8

Kapitali themeltar perbehet nga kontribute ne para dhe kontribute ne natyre dhe eshte i shlyer teresisht.

Neni 9

Aksionet e shoqerise zoterohen ne masen 100 % nga METE .

Neni 10

Transferimi i aksioneve tek te tretet behet konforme legjislacionit ne fuqi per privatizimin e prones shteterore.

KREU IV Organet Drejtuese

Neni 11

Organet drejtuese te shoqerise jane :

- Asambleja
- Keshilli Mbikqyres
- Drejtori i Pergjithshem

Neni 12

Te gjitha kopetencat e Asamblese se Pergjithshme te parashikuar nga Ligji 7638 " Per shoqerite Tregtare" ushtrohen nga Ministri i METE me cilesine e ortakut te vetem.

Neni 13

Asambleja eshte organi me i larte drejtues i shoqerise. Ajo thirret jo me rralle se nje here ne vit. Mbledhjet e saj zhvillohen ne seline e shoqerise, ose ne cdo vend tjeter te percaktuar ne rendin e dites.

Neni 14

Te drejten per thirrjen e Asamblese e kane :
Keshilli Mbikqyres
Drejtori i Pergjithshem .
Ekspetet Kontabel te autorizuar.

if

Neni 15

Ne cdo rast Drejtori i Pergjithshem eshte pergjegjes per pergatitjen dhe mbarevajtjen e mbledhjes se Asamblese.

f

Neni 16

Ne mbledhje te Asamblese mbahet Proces-Verbal. Rendi i dite se Asamblese duhet te permbaje percaktimin e mbledhjes si e zakonshme apo e jashtezakonshme, ceshtjen qe do te shqyrtohen, daten, oren dhe vendin e mbledhjes.

Neni 17

Ne mbledhjen e Asamblese marrin pjese pa te drejte vote anetaret e Keshillit Mbikqyres, Drejtori i Pergjithshem dhe Ekspertet Kontabel.

f

Neni 18

Ansambleja ne mbledhjet e saj merr vendime. Vendimet e Asamblese nenshkruhen nga kryesuesi i saj. Ato jane te detyrueshme per t'u zbatuar nga Keshilli Mbikqyres dhe Drejtori i Pergjithshem

f

Neni 19

Kompetencat e Asamblese se jashtezakonshme jane ato qe percaktohen ne Ligjin 7638 " Per Shoqerite Tregtare".

Neni 20

Asambleja e zakonshme miraton:

1. Programin e zhvillimit të shoqërisë,
2. Bilancin financiar, llogaritë dhe inventaret vjetore,
3. Raportin vjetor të administrimit.

Ajo emeron dhe shkarkon anëtarët e Këshillit Mbikqyres dhe rekomandon strukturën organizative, numrin maksimal të personelit drejtues dhe teknik, si dhe raportet e pagave të punonjësve të shoqërisë.

Neni 21

Këshilli Mbikqyres i shoqërisë përbëhet nga ~~6~~⁷ anëtarë. Anëtari i Këshillit Mbikqyres është person fizik dhe nuk mund të jetë i punësuar në shoqëri apo të emërohet Drejtor i Përgjithshëm i saj.

Neni 22

Anëtarët e Këshillit Mbikqyres ju nënshtrohen të gjitha përjashtimeve të përcaktuara me ligj apo akte nënligjore lidhur me funksionimin e tyre. Kohezgjatja e mandatit të anëtarit të Këshillit Mbikqyres është 4 vjet.

Kur vendi i një anëtarit të Këshillit Mbikqyres mbetet bosh për shkak të arsyeve, Asambleja brenda 3 muajve nga data e njoftimit, duhet të bëjë zëvendësimin. Anëtari i zgjedhur në këtë rast mbaron mandatin e anëtarit të zëvendësuar. Kur mbetet bosh vendi i kryetarit të keshillit, pavarësisht nga zgjedhja e anëtarit të ri, procedohet edhe për zgjedhjen e Kryetarit sipas dispozitave të përcaktuara në këtë statut.

Neni 23

Anëtarët e Këshillit zgjedhin nga radhët e tyre një Kryetar dhe një zv/kryetar, që ngarkohen me mbledhjen e Këshillit dhe drejtimin e diskutimeve.

Neni 24

Keshilli mbikqyres mblidhet te pakten cdo 3 muaj, por ai mund te mblidhet edhe sa here kerkojne interesat e shoqerise. Mbledhja e Keshillit Mbikqyres thirret nga kryetari dhe ne mungese te tij nga zv/kryetari. Mbledhjet e Keshillit Mbikqyres mund te kerkohen dhe nga 1/3 e anetareve te keshillit mbikqyres apo nga Drejtori i Pergjithshem i shoqerise. Ne kete rast kryetari e ne mungese te tij zv/kryetari jane te detyruar te therrasin keshillin brenda 15 diteve nga data e paraqitjes se kerkeses.

Neni 25

Lajmerimi per mbledhjen e Keshillit Mbikqyres behet minimumi 3 dite me pare me leter, telegram, telefaks ose faks. Ajo mund te behet edhe me goje, apo pa afat kur nje gje e tille pranohet nga te gjithe anataret e tij. Lajmerimi duhet te permbaje kurdohere rendin e dites dhe vendin, daten dhe oren e mbledhjes.

Neni 26

Mbledhja e keshillit Mbikqyres konsiderohet e vlefshme kur ne te marrin pjese me shume se 1/2 e anetareve te tij me perjashtim te mbledhjes per emerimin dhe shkarkimin e Drejtorit te Pergjithshem ne te cilen duhet te jene te pranishem jo me pak se 2/3 e anetareve. Anetaret e Keshillit Mbikqyres nuk mund te perfaqesohen ne mbledhjet e tij. Vendimet ne mbledhjen e keshillit merren me shumicen e thjeshte te votave te anetareve te pranishem. Ne rast te votave te barabarta vota e Kryetarit eshte percaktuese.

Per ceshtje urgjente me kerkesen e argumentuar te Drejtorit te Pergjithshem Keshilli Mbikqyres mund te marri vendime qarkulluese kur per to firmosin rregullisht jo me pak se 2/3 e anetareve te keshillit.

Neni 27

Keshilli Mbikqyres mban nje rregjister te pjesemarrjes se antareve ne mbledhjet e tij. Lista e pjesemarrjes ne cdo mbledhje nenshkruhet nga

anataret e pranishem. Mungesa ne mbledhje per me shume se 3 here radhazi, pa shkaqe te arsyeshme, sjell shkarkimin nga detyra. Per diskutimet dhe vendimet e Keshillit mbahet Proces-verbali i cili nenshkruhet nga Kryesuesi i mbledhjes dhe te pakten 2 anetar te pranishem.

Neni 28

Vendimet e Keshillit Mbikqyres nenshkruhen nga kryetari ose ne mungese te tij ne mbledhjen e keshillit nga zv/kryetari. Vendimet e marra rregullisht nga Keshilli Mbikqyres jane te detyrueshem per zbatim nga ana e Drejtorit te Pergjithshem .

Neni 29

Keshilli Mbikqyres ushtron kontroll te perhershem per administrimin e shoqerise nga Drejtori i Pergjithshem .

Keshilli Mbikqyres ka te drejte te kryej ne cdo kohe verifikime dhe kontrole qe ai i cmon te pershtateshme dhe kerkon te njihet me dokumentat qe ai i gjykon te nevojshme per permbushjen e detyres se tij. Keshilli Mbikqyres mund t'i ngarkoje njerit ose disa anetareve te tij cdo mandat te posacem per nje ose disa objekte te caktuara.

Neni 30

Keshilli Mbikqyres ka keto kompetenca:

- Ushtron kontroll te perhershem per administrimin e shoqerise nga Drejtori i Pergjithshem dhe i jep ketij te fundit autorizimin per kryerjen e operacioneve qe nuk mund te kryhen nga Drejtori i Pergjithshem pa autorizimin e Keshillit Mbikqyres.
- Keshilli Mbikqyres emeron Drejtorin e Pergjithshem.
- Me emerimin e Drejtorit te Pergjithshem Keshilli Mbikqyres lidh me te kontrate per detyrimet qe rrjedhin ne administrimin e shoqerise.
- Keshilli Mbikqyres autorizon Drejtorin e Pergjithshem qe te kryej veprimet dhe te realizoje marreveshjet e parashikuara ne nenet 12 dhe 13 te ketij statuti.

- Keshilli Mbikqyres ka te drejte te kryej ne cdo kohe verifikime dhe kontrole qe ai i cmon te pershtateshme dhe te njihet me dokumentacionin qe ai e gjykon te nevojshme per permbushjen e detyres se tij.
- Drejtori i Pergjithshem i paraqet raport Keshillit Mbikqyres te pakten nje here ne tre muaj. Brenda 3 muajve nga data e mbylljes se ushtrimit financiar Drejtori i Pergjithshem duhet t'i paraqese Keshillit Mbikqyres llogarite vjetore me qellim verifikimi dhe kontrolli.
- Keshilli Mbikqyres i propozon Ministrit te METE ne lidhje me keto ceshtje:
 - a- Percaktimin dhe ndryshimin e programit te veprimtarise afatshkurter, afat mesem dhe afat gjate te shoqerise.
 - b- Kryerjen e investimeve dhe financimeve per vitin financiar si dhe masat e tjera qe do te kerkonin ndryshimin e kapitalit themeltar te shoqerise.
 - c- Hapja e veprimtarive dhe njesive te reja dhe ndryshimin e objektit te shoqerise.
 - d- Shitjen e pasurive qe perbejne aktivin e qendrueshem te shoqerise, si dhe krijimin e shoqerive te reja dhe pjesemarrjen ne kapitalin e shoqerive te tjera.
 - e- Marrjen e huave afat mesem e afatgjate.
 - f- Si dhe cdo gje tjeter qe ne baze te Ligjit " Per shoqerite Tregetare" eshte kompetence e Asamblese se Pergjithshme.

Neni 31

Keshilli Mbikqyres verifikon, llogarite vjetore, bilancin financiar dhe inventaret e hartuara nga Drejtori i Pergjithshem dhe i paraqet Asamblese raportin e tij se bashku me raportin per administrimin vjetor te shoqerise nga ana e Drejtorit te Pergjithshem.

Neni 32

Keshilli Mbikqyres mund te zgjedh nje sekretar dhe jashte radheve te tij. Ai mund te miratoje rregullore per menyren e funksionimit te tij. Shperblimi i anetareve te Keshillit Mbikqyres behet ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi per kete problem.

Neni 33

Anetare te pare te Keshillit Mbikqyres jane:

- Bujar Leka
- Piro Dode
- Rajmonda Stefa
- Piro Lika
- Shpetim Nishani
- Ilir Dano

Neni 34

Veprimtaria e zakonshme e shoqerise drejtohet nga Drejtori i Pergjithshem , i cili emerohet per nje periudhe 4 vjecare me te drejte riemerimi . Drejtori i Pergjithshem nuk mund te jete mbi moshen 60 vjec.

Me propozimin e Drejtorit te Pergjithshem Keshilli Mbikqyres emerohet/shkarkon nje Zevendesdrejtor te Pergjithshem, i cili ndihmon Drejtorin e Pergjithshem ne administrimin e kompanise dhe e zevendeson ate ne rast te mungesave apo pushimeve .

Kompetencat e Zevendesdrejtorit te Pergjithshem caktohen ne Rregulloren e kompanise apo ne prokuren/autorizimin qe Drejtori i Pergjithshem i jep atij .

Neni 35

Drejtori i Pergjithshem nuk mund te beje pjese ne Keshillin Mbikqyres. Nese nje anetar i Keshillit Mbikqyres emerohet Drejtor i Pergjithshem, ai duhet te jape doreheqjen nga detyra e anetarit te Keshillit Mbikqyres. Drejtori i Pergjithshem nuk mund te jete anetar i nje drejtorie tjeter te shoqerive te kontrolluara por as dhe i shoqerive te tjetra tregetare.

Neni 36

Drejtori mund te shkarkohet ne cdo kohe nga Keshilli Mbikqyres vetem per shkaqe te arsyetuara qe lidhen me veprimtarine e shoqerise.

Neni 37

Drejtori i Pergjithshem ka te gjitha kompetencat per te ushtruar veprimtarine e zakonshme te shoqerise ne perputhje me legjislacionin ne fuqi, me vendimet e Asamblese dhe ato te Keshillit Mbikqyres.

Neni 38

Drejtori i pergjithshem perfaqeson shoqerine ne marrredheniet me te tretet. Keshilli Mbikqyres percakton kopetencat e Drejtorit te Pergjithshem.

Neni 39

(Drejtori i Pergjithshem pergjigjet per administrimin e shoqerise para Asambles dhe Keshillit Mbikqyres, ai nen pergjegjesine e tij paraqet cdo 3 muaj ne Keshillin Mbikqyres raport te hollesishem te veprimtarise se shoqerise. Ai eshte i detyruar t'u jap organeve drejtuese cdo informacion, cdo te dhene apo dokument qe keto te fundit e konsiderojne te vlefshem per kryerjen e detyrave te tyre.

KREU V

Kontrolli financiar dhe viti ushtrimor

Neni 40

Kontrolli financiar ushtrohet nga Ekspert Kontabet te autorizuar qe emerohen nga Asambleja dhe qe kryejne misionin e tyre ne pajtim me ligjin. Ekspert te pare Kontabel te autorizuar emerohen:

1. Baki Berberi
2. Njazi Laze
3. Fatos Haxhiraj
4. Kastriot Haxhaj

Neni 41

Ushtrimi financiar fillon me 1 janar dhe mbaron me 31 dhjetor te cdo viti kalendarik. Bene perjashtim viti i fillimit te veprimtarise, ne te cilin si date e fillimit te ushtrimit finaciar do te konsiderohet data 01.04.1999.

Neni 42

Shoqeria do te mbaje nje kontabilitet te rregullt te shoqerise dhe te veprimtarise se saj ne pajtim me kerkesat ligjore. Ne mbyllje te ushtrimit , drejtoria harton inventarin e pasurise ne kete date dhe llogarite vjetore per ushtrimin financiar. Drejtori i Pergjithshem pergatit gjithashtu raportin e administrimit vjetor te shoqerise ne te cilin duhet te evidentohet gjendja e shoqerise gjate ushtrimit financiar, ndryshimet e parashikuara per te ardhmen, ngjarjet qe kane ndodhur si dhe veprimtarite per te ardhmen.

Neni 43

Ne shpenzimet e shoqerise per vitin ushtrimor do te perfshihen dhe kostua e kontrollit te manaxhimit te shoqerise kontrolluese sipas percakimit ne aktin e themelimit.

Neni 44

Rezultati i ushtrimit percaktohet si difference ndermjet te ardhurave dhe shpenzimeve te ushtrimit pasi te jene zbritur humbjet e vitit te meparshem. Nga fitimet e ushtrimit te pakesuar, kur eshte rasti per humbjet e meparshme, hiqet te pakten 5 % (pese per qind) per te krijuar rezerven e domosdoshme. Heqja nga fitimet per rezerven e domosdoshme , nuk eshte detyrueshme, kur kjo rezerve arrine ne 1/10 (nje e dhjeta) e kapitalit themeltar. Ajo rifillon nje nje arsye cfardo, kur rezerva e domosdoshme ka zbritur nen 1/10 (nje te dhjeten) e kapitalit. Perdorimi i fitimit pas zbritjes se rezerves ligjore behet me urdher te Ministrit te METE.

KREU VI
Dispozita te fundit

Neni 45

Te gjitha kopetencat e Asamblese se Pergjithshme te parashikuara nga Ligji nr.7638 dt.19.11.1992 " Per Shoqerite Tregetare" qe nuk jane shprehur ne kete statut , ushtrohen nga Ministri i METE me cilesine e aksionerit te vetem.

Neni 46

Per cdo gje qe nuk eshte shprehur posacerisht ne kete statut i referohet legjislacionit ne fuqi per shoqerite tregetare.

Drejtori i Pergjithshem i shoqerise ARMO sh.a.

HALIM DARIU

